

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Mirëmbajtje e objekteve specifike ”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Shërbime për riparimin dhe mirëmbajtjen e materialeve të sigurisë dhe të mbrojtjes -50600000-1

VLERA E FONDIT LIMIT: 19,992,000 (nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e dymijë) lek, pa TVSH.

Vlera e fondit Limit në monedhën ndërkombetare Euro sipas kursit të Bankës së Shqipërisë është 199.282,29 (njëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e tetëdhjetë e dy presje njëzet e nëntë) euro.

Kursi zyrtar i këmbimit për monedhën euro sipas Bankës të Shqipërisë datë 18.07.2024 është 100.32 lekë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 dhe 82 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 26 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik...”*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; perkatesisht në vlerën 399,840 (treqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e dyzet) lekë dhe në monedhën euro sipas kursit të këmbimit datë 18.07.2024 është 3985.64 (tremijë e nëntëqind e tetëdhjetë e pesë presje gjashtëdhjetë e katër) euro.*

Kursi zyrtar i këmbimit për monedhën euro sipas Bankës të Shqipërisë datë 18.07.2024 është 100.32 leke.

Argumentimi: *Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 83 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenin 30, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se:*

“...Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël...”

“...Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe...”

2. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me standartin ISO 9001, për sistemin e menaxhimit të cilësisë, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

2.1.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me standartin ISO 27001 për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

Argumentimi: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sa më sipër janë vendosur në mbështetje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Nenit 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

Çertifikata e standardit të cilësisë ISO 9001 (ose ekuivalente) është sot referimi i njohur në nivel ndërkombëtar, për certifikimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë të kompanive të të gjithë sektorëve dhe të gjithë përmasave. Ky kriter kërkohet nga AK për të vërtetuar cilësinë e shërbimit

sipas standardeve ndërkombëtare, përmirësimin e vazhdueshëm të këtij shërbimi të ofruar nga operatorët ekonomik si dhe garantimin e realizimit në kohë dhe me sukses të objektit të kontratës.

Çertifikata e menaxhimit të sigurisë së informacionit ISO 27001 (ose ekuivalente) është e nevojshme pasi përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të sigurisë së informacionit. Në raport me informacionin e administruar nga sistemi i kamerave gjykohet se ky informacion duhet mbrojtur nga Kontraktori. Sistemi i sigurisë së informacionit sa më sipër kërkuar, parandalon kapjen, fshirjen, modifikimin ose kopjimin e informacionit dhe rrjedhimisht dhe keqpërdorimin e tij. Çertifikimi sipas kësaj kategorie konfirmon ekzistencën dhe funksionimin e kontrolleve të OE ofertues dhe i jep sigurinë e nevojshme autoritetit kontraktor mbi sigurinë e informacionit që do të administrohet nga kamerat e vendosura në objekte.

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, sa vlera e fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 3, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik" në të cilin përcaktohet se:

" 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës në procedurat mbi kufirin e lartë monetar.

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse autoriteti kontraktor kërkon që të garantohet se operatori ekonomik ofertues e ka kapacitetin ekonomik të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, pra që të këtë realizuar xhiro në fushën e objektit të prokurimit, njësia e prokurimit vendosi që të hartonte dhe përcaktonte këtë kërkesë për kualifikim.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit "Procedure e Hapur mbi kufirin e lartë monetar– Shërbime" ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 43, pika 1 e 2 "Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare", dhe Kreu II "Kufijtë monetarë" të VKM nr. 291, datë

15.05.2024 "Për përcaktimin e kufijve monetare në procedurat e prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

Neni 43

Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare

Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...;

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.;

KREU II

KUFIJTË MONETARË NË SEKTORIN KLASIK

1. Kufiri i lartë monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 603 000 000 (gjashtëqind e tre milionë) lekë;

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë.

2. Kufiri i ulët monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë;

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

Lidhur me vitet financiare për të cilat kërkohet që të jetë e realizuar xhiro e kërkuar, njësia e prokurimit duke ju referuar përcaktimeve të nenit 43, të VKM nr. 285, datë 15.06.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar ku është përcaktuar se deklarata e xhiros vjetore mund të kërkohet deri në tre vitet e fundit financiare, si dhe nisur nga përcaktimi i pikës 7 të Rekomandimit të APP Nr.7998 datë 24.12.2021 "Mbi hartimin e kritereve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime" ku përcaktohet se në nenin 19 të ligjit nr 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, deklarata vjetore e të ardhurave nga subjektet tatim paguese deklarohet në organe tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, prandaj njësia e prokurimit meqënëse procedura e prokurimit do të zhvillohet në korrik të vitit 2024 dhe tatimpaguesit kanë afat deri më 31 mars 2024 të deklarojnë xhiron e realizuar në vitin 2023 përcaktoi si 3 (tre) vite të fundit financiare vitet 2021, 2022 dhe 2023.

Lidhur me vlerën e xhiros vjetore të përcaktuar, meqënëse procedura e mësipërme e prokurimit është mbi kufirin e lartë monetar u përcaktua që vlera e xhiros vjetore të jetë sa vlera e përllogaritur e fondit limit.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të kete nje aktivitet pozitiv te qendrueshem gjate 3(tre) viteve te fundit. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti operatorët ekonomik duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit*

ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, gjithashtu është kërkuar auditimi ligjor i pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese në rastet e parashikuara në nenin 41, pika “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024 ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Njësisë së Qeverisjes Vendore ku operatori ekonomik ka selinë.. Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në përputhje me pikat 1 dhe 3, të nenit të 77 si dhe nenin 76, pika 2, gërma b të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore“ i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2024 në të gjitha vendet ku ushtron aktivitet ekonomik sipas të dhënave të QKB-së.

2.2 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme Autoriteti Kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më të vogël se 40% e vlerës së fondit limit** dhe konkretisht jo më të vogël se vlera: **7.996.800 (shtatë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind) lekë pa tvsh** ose **79.712,91 (shtatëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e dymbëdhjetë presje nëntëdhjetë e një) Euro** (Kursi i këmbimit referuar kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë me datë 18.07.2024 është 100.32 lek). Shërbimet e mëparshme të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në

fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlllogaritur të fondit limit për këtë lot. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 3 (tre) punonjës të siguruar, të diplomuar në fushat si më poshtë:

- a) 1 (një) Inxhinier elektronik
- b) 1 (një) Inxhinier Informatik/Specialist TIK
- c) 1 (një) Inxhinier Telekomunikacioni/Inxhinier Elektrik

Sa më sipër do të vërtetohen nëpërmjet dokumentacionit të mëposhtëm provues:

- Kontratata individuale të punës
- Diplomat përkatëse
- Listëpagesa ku të figurojë emri i inxhinierit të deklaruar për periudhën kohore të tre muajve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77/1 gërma c), neni 77 pika 4 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe bazuar në nenin 41 pika 4, gërma (b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

Referuar objektit të prokurimit dhe termave të referencës të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë kërkuar specialistë të nevojshëm për realizimin e shërbimeve të kërkuara në specifikimet teknike të kësaj procedure. Në këtë shërbim kërkohen disa lloje inxhinierësh, pasi sistemi i kamerave termale është specifik dhe kërkon mbulim profesional dhe ekspertizën e nevojshme në disa fusha sikunder është kërkuar elektrike, elektronike dhe referuar zërave të preventivit ku parashikohet mirëmbajtje e sistemeve perimetrale dhe shërbimi i internetit është parashikuar dhe inxhinieri informatik/ Specialist TIK .

Disponimi i stafit teknik të kërkuar krijon bindje tek Autoritetin Kontraktor se OE ofertues ka kapacitetet profesionale për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të ketë minimumi 3 (tre) punonjës të siguruar si montues të pajisjeve elektronike/teknik elektronik, kjo e vërtetuar me kodin në listpagesat e 3-muajve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Montuesit kërkohen pasi kamerat termale është e pozicionuar në majën e një kulle 20 m të lartë dhe me një peshë mbi 50 kg.

Argumentimi: *Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale të shoqërisë është kërkuar personel i nevojshëm staf teknik referuar shërbimit që duhet të kryhet nga operatorët ekonomikë për monitorimin në distancë me kamera dhe sisteme alarmi në mbështetje të pikës 4 të Nenit 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se “në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” si dhe në mbështetje të Nenit 41 të VKM Nr. 285, date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, pika 4, germa (b) ku specifikisht përcaktohet: Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: :..... një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose...”*

*Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit të prokurimit. Sqarojmë se, stafi teknik është kërkuar në përputhje me termat e referencës ku kërkohet specifikisht që operatori ekonomik të kryejë shërbimin e mirëmbajtjes së kamerave dhe nevojitet montues të cilët të jenë persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme pasi kamerat janë pozicionuar në majën e një kulle 20m të lartë dhe kanë peshë mbi 50 kg . Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar kodi përkatës në listëpagesat për periudhën e **3 (tre) muajve**.*

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të ketë minimumi 2(dy) punonjës të certifikuar nga kompania prodhuese e sistemeve të kamerave, e vërtetuar me certifikatën përkatëse dhe të figurojnë në listëpagesën e 3- muajve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të ketë minimumi 2(dy) punonjës të certifikuar nga kompania prodhuese e sistemeve të alarmeve, e vërtetuar me certifikatën përkatëse dhe të figurojnë në listëpagesën e 3- muajve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Argumentimi: *Në përshkrimin e termave të referencës përcaktohet se parashikohet shërbimi i mirëmbajtjes së kamerave dhe i shërbimi i mirëmbajtjes së sistemeve të ruajtjes perimetrale (CCTV+Alarm). Në kuadër të mirëmbajtjes së sistemeve të prodhuara prej tyre si sistemi i kamerave termale dhe sistemi i alarmit perimetral prodhuesit vendosin kritere teknike, organizative për burimet njerëzore dhe për procedurat e brendshme të shoqërive. Këto programe/kushte ndërtohen nga vetë prodhuesit dhe ata në këtë mënyrë marrin përsipër cilësinë e shërbimeve të ofruara nga shoqëritë. Në shume raste, kalimi i çertifikimeve i kualifikon shoqëritë si të autorizuar prej tyre për realizimin e shërbimeve të ndërhyrjes, përmirësimit apo përditësimit të sistemeve të kamerave apo sistemeve të alarmit. Nëse shoqëritë nuk kanë punonjës të certifikuar*

nga prodhuesit (për sisteme) çdo ndërhyrje për mirëmbajtjen e tyre nga persona të paautorizuar rrezikon përfundimin e kushteve të garancise apo të mirëmbajtjes së prodhuesit.

Për këtë, çertifikimet e mësipërme që kanë lidhje me shërbimet që do të kryhen për mirëmbajtjen e kamerave termale dhe mirëmbajtjen e sistemeve të alarmit që kërkohen si pjesë e integruar e shërbimit jo vetëm që përbëjnë një nevojë për garantimin e cilësisë së shërbimit, por ato janë direkt të lidhura edhe me kërkesat e prodhuesve për mirëmbajtjen. Ndërhyrjet në sistem nga punonjës të pa-çertifikuar mundet të dëmtojnë vetë sistemin, të dhënat që mbahen në sistem dhe/ose në kuadrin e sigurisë së informacionit apo të bëhen shkak për aksesin ose dëmtimin e informacionit nga/në persona apo drejtime te paautorizuara.

Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për tu garantuar që Operatori Ekonomik ka mbështetjen e prodhuesit për të garantuar cilësinë e produkteve të nevojshme për realizimin e shërbimit për përmbushjen me sukses të kontratës, duke garantuar funksionimin e kamerave termale dhe alarmit që kanë një rendësi të vecantë për dedektimin e zjarreve në pyje. Dëmtimi dhe mosfunksionimi i tyre është me pasoja financiare dhe teknike-organizative për autoritetin kontraktor

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të ketë minimumi 2(dy) punonjës te pajisur me Deshmi Kualifikimi të Sigurimit Teknik per punonjesit që punojnë me impiantet , pajisjet dhe instalimet elektrike apo më afërsi të tyre, e vertetuar me certifikaten perkatese/dëshminë e lëshuar nga organe të akredituara nga DA dhe te figurojnë ne listëpagesen e 3- muajve te fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Argumentimi: *Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale të shoqërisë është kërkuar personel i nevojshëm staf teknik referuar shërbimit që duhet të kryhet nga operatorët ekonomikë për monitorimin në distancë me kamera dhe sisteme alarmi ne mbeshtetje te pikës 4 të Nenit 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se “në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” si dhe në mbështetje të Nenit 41 të VKM Nr. 285, date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, pika 4, germa (b) ku specifikisht përcaktohet: Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: :..... një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose...”.*

Gjithashtu autoriteti kontraktor në përcaktimin e këtij kriteri i është referuar dhe ligjit nr. 8734 datë 01.02.2001, “Për Garantimin e Sigurisë së Punës të Pajisjeve dhe Të Instalimeve Elektrike” pasi ,me qëllim sigurimin teknik të punonjësve të cilet do të realizojnë shërbimet në lidhje me këto paisje si vënia në shfrytëzim ose heqja nga puna, përdorimi, transporti, riparimi, modifikimi, mirëmbajtja, duke përfshirë edhe pastrimin.

Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit specifik si dhe të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit të prokurimi.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet te paraqesi nga kompanite prodhuese te kamerave dhe alarmeve nje deklarate/autorizim se do te ofrojne support per operatorin ekonomik gjate gjithe periudhes se mirembajtjes .

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 paragrafi c) i VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që gëzojnë autoritetin e duhur të deleguar nga prodhuesi për të shërbyer në pajisjet që do të mirëmbajnë. Kjo minimizon riskun për mos respektimin e kushteve të kërkuara mbi kohën dhe cilësinë e shërbimeve që do të ofrohen.

2.3.8 Operatori Ekonomik që do të realizojë shërbimin duhet të disponojë të paktën 1 (nje) automjet fuoristrade pick-up për realizimin e instalimeve shoqeruar me dokumentacionin sa me poshtë:

Në rastin e automjetit në pronësi dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, Çertifikaten e pronesise, taksat vjetore dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe per mjetet e siguruara me qera, dokumenti qe verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (të vlefshme), taksat vjetore dhe Çertifikatën e pronesise, te shoqeruara me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar ne nenin 77 , të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” nenit 41 pika 4/ç të VKM nr.285 ,datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Autoriteti/enti kontraktor kerkon mjetet dhe pajisjet teknike te nevojshme per ekzekutimin e objektit te prokurimit qe ka ne dispozicion apo mund ti vihen ne dispozicion.

Per vete natyren e procedures se prokurimit mjeti pick up nevojitet per instalimet apo nderhyrjet teknike qe duhet te realizohen neper objektet ku jane te vendosura kamerat me qellim realizimin ne kohë e me eficencë të kontratës ne tërësi.

Argumentimi për mosndarjen në lote:

Nuk është rasti kur kontrata ndahet në lote, në këtë rast kontrata nuk përbëhet nga punë, mallra apo shërbime, homogjene ose të ngjashme si nuk është rasti që vlera e kombinuar është e tillë që vetëm një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë do të ishin në gjendje t’i siguronin ato. Gjithashtu mos ndarja ne lote eshte me pak e kushtueshme per AK. Menaxhimi dhe ofrimi i shërbimeve janë më të lehta dhe më pak të kushtueshme për sa i takon kohës, burimeve njerezore dhe logjistike.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Referuar shërbimit që kërkohet të kryhet, atij të mirëmbajtjes së sistemeve të monitorimit të kamerave termale, për parandalimin e zjarreve dhe dëmeve në ekonomitë pyjore ku përfshihen Kamerat termale me detektim zjarri dhe identifikim të njerëzve dhe mjeteve, sistemet e sigurisë perimetrale të kullave të monitorimit të përbëra nga sisteme vëzhgimi cctv dhe sisteme alarmi, serverit të mbledhjes dhe procesimit të të dhënave nga Grupi i punës janë hartuar termat e referencës dhe specifikimet teknike, duke qënë se ato, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin

36 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, njësia e prokurimit miratoi specifikimet teknike për shërbimin objekt prokurimi.

Termet e referencës dhe specifikimet teknike për realiziminj e shërbimit sa më poshtë:

Qëllimi i përgjithshëm i kësaj procedure është mirëmbajtja e sistemeve të monitorimit të kamerave termale, për parandalimin e zjarreve dhe dëmeve në ekonomitë pyjore ku përfshihen Kamerate termale me detektim zjarri dhe identifikim të njerëzve dhe mjeteve, sistemet e sigurisë perimetrale të kullave të monitorimit të përbëra nga sisteme vëzhgimi cctv dhe sisteme alarmi, server i mbledhjes dhe procesimit të të dhënave dhe salla e monitorimit qëndrore. Objektet në të cilat janë të vendosura sistemet janë:

1. Maja e Derjes	Kulla e monitorimit në Dajt (2015)
2. Petrelë	Kulla e monitorimit në Petrelë (2023)
3. Peze	Kulla e monitorimit në Pezë (2023)
4. Salla e monitorimit në APR	2023

Operatori ekonomik do të ofrojë asistencë teknike dhe mirëmbajtje të sistemeve të sigurisë në kullat e monitorimit të pyjeve, në çdo komponent të tyre, me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së punës. Kompania fituese duhet të garantojë që sistemet do të jenë funksionale 24/7, dhe do të korrigjojë çdo difekt që mund të shfaqet gjatë gjithë periudhës së mirëmbajtjes së sistemit.

• MIRËMBAJTJE E KAMERËS TERMALE (3 copë)

Në këtë zë përfshihet mirëmbajtja e kamerave termale me detektim zjarri, njerëzish dhe mjeteve të instaluar në 3 pika, Majen e Derjes, Pezë dhe Petrelë .

Operatori ekonomik duhet të kryejë shërbime të vazhdueshme për të garantuar funksionalitetin 24/7 të këtyre kamerave.

Në detyrat e operatorit ekonomik përfshihen;

- Mirëmbajtje e kamerës termale për parandalimin e problematikave që vijnë nga kushtet e vështira atmosferike;
- Riparimi pjesëve të dëmtuara të kamerës termale;
- Kontroll periodik i aftësisë të pajisjeve për regjistrimin dhe funksionimin e pajisjeve;
- Riparim apo zëvendësim i pjesëve të ushqyesve të kamerës së monitorimit të pyjeve;
- Riparim, mirëmbajtje e rrjetit të transmetimit video (FTP), data dhe fibrës optike për kamerën e monitorimit të pyjeve;
- Pastrimin e lentes termale dhe asaj optike për të patur pamje sa më të qarta.
- Konfigurime sipas funksionaliteteve të përcaktuara në specifikime teknike;
- Asistencë teknike 24/7 për stafin e Sallës së Monitorimit;

Specifikimet teknike të kamerave termale :

1. KAMERA TERMALE QË ËSHTË MONTUAR NË VITIN 2015 NË MAJËN E DERJES ME ZONË MBULIMI EKONOMITË PYJORE KOLLOGJESH, BIZE, FAG-TIRANE”

Kamera termike me zbulimin e zjarrit dhe identifikimin e personave dhe automjeteve

Detektim deri 2mX2m zona nxehtësie

Distanca 6000m

Gjenerata Sensor 5

336 * 256 rezolutë pixel (640 * 512 optional)

Spektri 7.5 ~ 14µm

NETD 50mK (@ 25 °C F1.0)

Lentja 31-155mm

FOV 18 ° * ° ~ 3.4 ° 13,5 * 2,7 * 8,5 ° 11:25 ° ° ° * 02:25 ~ 1.7 °

Lens kontrollit Motor zoom, fokus (fokusi optional auto) CCD1 / 1.8"CMOS, 2 megapixel automatik ICR sëitch, elektronik e stabilizimin e imazhit, zgjerimin image. lente korigjimi 15 ~ 528 mm HD Infrared korigjim lente përpunimin e imazhit temperature të qëndrueshme, operacion pa TEC, duke filluar nga koha pak se 4s2e. cSoDnEd përpunimit digital imazhit.

10 ngjyra pseudo dhe B / Ë, B / Ë inverse

Ndriçimi, kontrast, korigjim i gama

2X përforsim dixhital

Funksioni Optional PENETRATE mjegull

objektiv Hot

alarm Inteligjente

255 vlerat e pragut të alarmit rregullueshme

Zona Adjustable monitorimit, zbulimin auto të madhësisë së synuar

1-16 objektivat alarm, zgjedhja auto i një më të dukshme

Dy llojet e alarmit: ekran ekran dhe alarmi audible

Përgjigja pak se 0.01s alarm siguron asnjë lëshim

Pesha : 30kg 50kg

Rrotullimi: pan: 0 ~ 360 °, anim: -75 ° ~ + 45 °

Rrotullimi: Pan: 0 ~ 360 °, anim: -45 ° ~ + 45 °

Shpejtësinë e rrotullimit: Pan: 0.1 ~ 60 ° / s, Tilt: 0.1 ~ 30 ° / s Kupë: 0.1 derinë 30 ° / s, anim: 0.1 derinë 15 ° / s

Të mundësojë funksione të tilla si dalje skanim ëndproof, anti-shake, funksion automatike mbyllje, funksioni menu OSD, vendndodhja, në kohë reale ekranit

Të marrë informacion në kohë reale mbrapa azimuth, lidhja me hartë GIS vendndodhjen

Ndër faqe RS-485 (norma 2400bps Pelco D protokollare, baud), PAL / NTSC, rrjeti HD, kaloni alarm. AC24V (DC24V opsionale) lidhësi pa përshkueshëm nga uji

Temp Operimit: -35 ° ~ 55 ° (-45 ° optional)

3, Konsumi I energjisë: 100Ë normal, fillojnë kulmin, 150 ë

2. KAMERA TERMALE QË JANË MONTUAR NË PEZË DHE PETRELË (2 COPË).

Karakteristikat e KAMERAVE	Vlerat specifike
Tipet & Nën tipe te Kamerave:	Kamera Thermal Outdoor 360°, PTZ HIKVISION Tipi sensorit: Vanadium Oxide Uncooled Focal Plane Arrays Rezolucioni: 640 × 512 (rezolucioni i imazhit në dalje 1920 × 1080) Intervali Pikselave: 17 µm Gjatësia e valës: 8 µm to 14 µm
Moduli Termik ("Thermal Module"):	Gjatësia fokale e lenteve: 30 to 150 mm Modaliteti i fokusit: Gjysmë automatik & manual

	<p>IFOV: 0.57 në 0.11 mrad Këndi i shikimit: F0.8 në F1.2 Fushëpamja: 20.56° × 16.51° (H × V) to 4.15° × 3.32° (H × V) Distanca minimale e fokusimit: 3m Zmadhimi dixhital: x2, x4, x8</p>
Moduli Optik("Optical Module"):	<p>Tipi sensorit: CMOS Sensor Madhësia e Sensorit: 1/1.8" Rezolucioni: 2688 x 1520, 4MP Ndriçimi min: Color: 0.0005 Lux, B/Ë: 0.0001 Lux Fushëpamja: 60° × 35.8° (H × V) to 1.2° × 0.7° (H × V) Gjatësia fokale e lenteve: 6.7 në 330 mm, 49x Kendi i shikimit : F1.5 në F5.3 Modaliteti i fokusit: Gjysmë automatik & manual Shpejtësia e diafragmës: 1s to 1/30,000s ËDR: 120 dB Zmadhimi dixhital: x2, x4, x8</p>
Efektet e imazhit ("Image Effect"):	<p>PiP: Shfaq imazhin e pjesshëm të kanalit termik në ekranin e plotë të kanalit optik Ngjyrosja e synuar: Mbështetet në modalitetin e nxehtë (të bardhë dhe të zi)</p>
PTZ:	<p>Menyra Lëvizese: Pan: 360° Rrotullimi i vazhdueshëm; Tilt: nga -45° në +45° (rrotullim automatik) Shpejtësia PAN: i Konfigurueshëm, nga 0.01°/s në 40°/s, Shpejtësia e paracaktuar: 240°/s Shpejtësia Tilt: i Konfigurueshëm, nga 0.01°/s në 40°/s, Shpejtësia e paracaktuar: 240°/s Zmadhimi proporcional: PO Paracaktimet: min 300 Skanimi i modelit: 4, Më shumë se 10 minuta për model Skanimi i patrullës: 8, Deri në 32 paracaktime për patrullë Fikja e kujtesës: PO Mënyrat e skanimit: Pattern Scan/Patrol Scan/Auto Scan/Tilt Scan/Random Scan/Frame Scan/Panorama Scan Automatizim Skanimi: Pattern Scan/Patrol</p>

	Scan/Auto Scan/Tilt Scan/Random Scan/Frame Scan/Panorama Scan
Main Stream	Moduli optik 50 Hz:25 fps (2688 × 1520, 1920 × 1080, 1280 × 960, 1280 × 720) 60 Hz:30 fps (2688 × 1520, 1920 × 1080, 1280 × 960, 1280 × 720) Moduli termik 50 fps (1920 × 1080, 1280 × 960, 1280 × 720, 704 × 576, 640 × 480, 384 × 288)
Sub-Stream	Moduli optik 50 Hz:25 fps (704 × 576, 352 × 288) 60 Hz:30 fps (704 × 576, 352 × 288) Moduli termik 50 fps (704 × 576, 640 × 480, 384 × 288)
Netëork:	Të suportoj protokollet: IPv4/IPv6, HTTP, HTTPS, 802.1x, Qos, FTP, SMTP, UPnP, SNMP, DNS, DDNS, NTP, RTSP,RTCP, RTP, TCP, UDP, IGMP, ICMP, DHCP, PPPoE Të suportoj, memorie lokale deri ne 265GB (MicroSD/SDHC/SDXC) Të suportoj protokollin ONVIF
Alarm:	Alarm imput: min. 7 kanalë Alarm ouputs: min. 2 kanalë Audio imput: min. 1 kanalë Analog video output: min. 1 kanalë
Multi Streaming:	Min.Dual-Streaming
Dedektimi i automjeteve me përmasa 1.4 x 4.0m	Min. 13500m
Dedektimi i njerëzve me përmasa 1.8 x 0.5m	Min. 4400m
Njohja e automjeteve me përmasa 1.4 x4.0m	Min. 3300m
Njohja e njerëzve me përmasa 1.8 x 0.5m	Min. 1100m
Identifikimi i automjeteve me përmasa 1.4 x 4.0m	Min. 1650m
Identifikimi i njerëzve me përmasa 1.8 x 0.5m	Min. 550m
Analizimi i video kontentit për automjete 1.4x4.0m (VCA)	Min. 3100m

Analizimi i video kontentit për Njerëzit 1.8 x 0.5m (VCA)	Min. 1000m
Matja e temperaturës (objekt 2 x 2m)	Min. 3500m
Matja e temperaturës (objekt 1 x 1m)	Min. 1750m
Dedektimi i zjarreve (objekt 2 x 2m)	Min. 8800m
Dedektimi i zjarreve (objekt 1 x 1m)	Min. 4400m
Temperatura e funksionimit:	Outdoor (Të jashtme) :-40°C to 65°C
Formati i Kompresimit të Videos:	H.265+/H.265/H.264+/H.264
Rezistenca Ndaj:	Mbrojtje nga rrufeja TVS 6000V IP66 Mbrojtja nga mbi tensionet dhe tensioni kalimtar
Ushqimi:	48 VDC ± 20% Konsumi: 48 VDC, 5 A, Max. 220 Ë
Aksesorët për montim:	Po,sipas tipit të kamerës dhe mënyrës së montimit

- **SHËRBIMI I MIRËMBAJTJES SË SALLËS SË MONITORIMIT DHE SERVERIT**

Në këtë zë, operatori ekonomik do të ofroj mirëmbajtjen e pajisjeve të sallës së monitorimit ku menaxhohet i gjithë informacioni i transmetuar në kohë reale nga 3 kullat e monitorimit.

Të dhënat teknike të pajisjeve janë:

MONITOR PER VIDEOËALL (6 cope)

Karakteristika te Monitor	Vlerat specifike
Tipet & Nëntipete Monitor:	55"
Rezolucioni:	3840 × 2160
Raporti i kontrastit:	1100: 1
Materiali i mbështjelljes:	Plastik
Video & Audio Input:	HDMI × 2, VGA × 1
Color Display:	10 bit
Rezistenca:	Monitori duhet të jetë rezistent që të punoj 24/7

MODUL MENAXHIMI PËR VIDEOËALL (1 cope)

Karakteristikate Video Ëall	Vlerat specifike
Tipet & Nëntipete Video ËALL:	Video ëall 2X2 + Video Procesor
Video & Audio Input:	VGA, DVI-I, 1920x1080
Video & Audio Output:	HDMI x 8, BNC x 4

Rezolucioni:	4K, 1080p
Ndarja e ekraneve:	1/4/6/8/9/12/16/25/36
Formati i kompresimit të Videos:	Min. H.265+
Portat e rrjetit:	RJ45 × 2, 10/100/1000 Mbps adaptive Modul fiber optike × 2, 100 base-FX/1000 base-X
Porta seriale:	RS-232 × 1, RS-485 × 1
Porta USB:	PO, Min. 1/1
Alarme (hyrje/dalje):	Min. 8/8
Protokolle:	PS, RTP, TS, ES
Temperatura e funksionimit:	-10°C deri +55°C

SERVER

Karakteristika te Sistemit	Vlerat specifike
Sistemi i operimit:	Microsoft ëindoës 11 (64-bit) OEM
Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net	12200
RAM:	Min. 16 GB DDR4, 2400 MHz, Non-ECC
Madhësia e Hard Diskut “SSD Size”:	Min. 1 TB
Shpejtësia e Hard Diskut “SSD Speed”:	Min. 500 MB/s Read / 500 MB/s ërite
Karta Grafike:	Min. 12 GB, NVENC
Slotet:	Min. 2 x PCI/PCI-E, nga të cilat Min. 1 x PCI-E 3.0 x16
Portat e Komunikimit:	Min. 1 x 3 USB port Para Min. 4 x USB 3.0 Pas Min. 1 x Type-C Min. 1 x Audio In/Out, Min. 1 x Mic. dhe 1 x Headphone Min. 2 x DP Min. 1 x VGA
Porta e rrjetit:	1 x 10/100/1000 RJ45
Sound:	Integrated Sound Card
Speakers:	Internal or Built-in Monitor
Siguria “Security Management”:	Embedded Security TPM 2.0

Për pajisjet e mësipërme operatori ekonomik do të ofrojë:

1. Mirëmbajtjen hardëare për të gjithë infrastrukturën fizike;
2. Suport remote nëpërmjet telefonit për specialistët e Sallës së Monitorimit;
3. Asistence teknike on-site në rast problematikash të pazgjidhura me remote brenda 2 orëve nga moment i njoftimit zyrtar;
4. Riparimi pjesëve të dëmtuara;
5. Kontroll serverit për problematika të ndryshme;
6. Azhurnime periodike për serverin.
7. Shërbime periodike të mirëmbajtjes parandaluese;

- **SHËRBIMI I MIRËMBAJTJES SË SISTEMEVE TË RUAJTJES PERIMETRALE (CCTV+ALARM)**

Në cdo pikë ku janë instaluar kamerat termale , zona ruhet me sisteme vëzhgimi kamerash perimetrale dhe sisteme alarmi inteligjente.

Operatori ekonomik duhet të ofrojë :

- Pastrimi, mirembajtja, riparimi në rast defekti i pjesëve të kamerave apo paisjeve të regjistrimit të sistemit të sigurisë së kamerave perimetrale.
- Kontroll periodik i aftësisë të pajisjeve për regjistrimin dhe funksionimin e pajisjeve;
- Pastrimi, mirëmbajtja, riparimi në rast defekti i pjesëve të ushqyesve të kamerave dhe pajisjeve regjistruese, sëitch, konvertera etj;
- Riparim, mirëmbajtje i rrjetit të transmetimit video (FTP), data dhe fibrës optike për sistemin monitorimit të sigurisë perimetrale;
- Riparim, mirëmbajtje e pajisjeve të Centralit të alarmit;
- Riparimi/ konfigurimi sensorëve inteligjentë;
- Riparimi/konfigurimi sensorëve;
- Riparimi/konfigurim i modulit të alarmit;
- Konfigurim i sensorëve inteligjente dhe modulit të alarmit;

- **SHËRBIM INTERNET 10MPBS/10MBPS**

OE do sigurojë shërbimin internetit të nevojshëm për transmetimin e kamerave termale dhe sistemeve të sigurisë perimetrale nga 3 pikat ku janë montuar kullat e vrojtimit (Maja e Derjes, Peze, Petrele) për periudhën 24 (njëzet e katër) muaj.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 41, pika 1, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performancë, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJËSIA E PROKURIMIT

